



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN121120240001

Tiranë, më 18.12.2024

Komisioni 166

## DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi Juridik:** “F E R R A J” Sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** K52302013A

**Adresa e selisë:** Urra e Brrarit, Komuna Dajt, Tirane.,Dajt

**Personi përgjegjës:** Urim Allushi

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror**”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Leja Minerare Nr. 1913, Dt 22.06.2021, Objekti “Ferraj”, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë.

### **Të dhëna teknike:**

*Mbështetur në deklaratimet e AKBN-së.*

Sipërfaqja totale e lejes minerare është 0.086km<sup>2</sup>

Sipërfaqja e lejes minerare ekzistuese është 0.043km<sup>2</sup>

Sipërfaqja e lejes minerare e zgjeruar është 0.043km<sup>2</sup>

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

- *Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet si më poshtë vijon:*
- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar. Në raport citohet VKM e pandryshuar.
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, date 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar. Në raport citohet VKM e pandryshuar.
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet si më poshtë vijon: Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjisllacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, nëse do të ketë përdorim të lëndëve plasëse, përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, shprehem si më poshtë vijon:

- Vihet re se në këtë raport nuk është cituar ligji aktual në fuqi nr. 162/2014, i ndryshuar “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i cili shoqërohet me disa akte nënligjore të dala në zbatim të tij.

- Vihet re se në këtë raport nuk është cituar as ligji në fuqi nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve shprehet si më poshtë vijon:

Të dy sektorët si i pyjeve ashtu edhe sektori i mbrojtjes së natyrës shprehen kundër miratimit, për arsye si më poshtë vijon:

- në dokumentacion nuk relatohet nëse është patur parasysh pika 6, neni 10, i ligjit 57/2020 “Për pyjet” dhe në mënyrë të veçantë neni 12, i tij; - nuk parashtrihen dhe saktësohen të dhënat/informacionet për përdorimin e sipërfaqes që do të përdoret përherë apo përkohësisht nga projekti (kjo bazuar në VKM nr.686, datë 29.7.2015, të ndryshuar dhe VKM 912, datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit në mjedis);
- në dokumentacion nuk gjejmë të përfshirë konsultimin me publikun, si dhe nuk gjejmë mendim nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki apo Njësia e Qeverisjes Vendore;
- nuk pasqyrohet si dhe sa janë realizuar detyrimet sipas lejes së shfrytëzimit derisa është kërkuar zgjerimi i saj;
- duhen të saktësohen masat për mbrojtjen nga zjarret në raste aksidentesh;
- nuk parashikon asnjë procedure si do të veprohet lidhur me ndryshimin e destinacionit (formës së përdorimit) të sipërfaqes që do të përdoret për projektin.

Sugjerojmë marrjen e mendimit të AKZM-se dhe institucioneve të tjera lidhur me zhvillimin e projektit.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se:* Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror Leja Minerare Nr. 1913, dt 22.06.2021”, Objekti “Ferraj”, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, me zhvillues “FERRAJ” dhe aplikues “INNOVATION DEVELOPMENT ENGINEERING”, me nr. Aplikimi AN290720240003, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

*Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore shprehet:* në shkresën me nr.8369/1 prot, datë 20.09.2024, shprehet si më poshtë vijon:

Sipërfaqe totale për heqje nga fondi pyjor është 8.65 Ha.

Sipërfaqja e lejes minerare Nr 1913, datë 22.06.2021, të shfrytëzimit është S-0.043 km<sup>2</sup>

Sipërfaqja e lejes minerare për shfrytëzim së bashku me zgjerimin është S-0.086 km<sup>2</sup> ose 8.65 Ha.

2. Nuk është keyer rehabilitimi i sipërfaqes ekzistuese të shfrytëzuar pasi aktiviteti mineral i këtij subjekti është në zhvillim

*Ministria e infrastrukturës dhe Energjisë shprehet se:* Në vijim të aplikimit me Nr. AN290720240003, të depozituar në sistemin elektronik të lejeve për të cilin keni kërkuar mendim për VNM-në e thelluar - Njoftim, për objektin: “Shfrytëzimi i mineralit Gur Gëlqeror, Leja Minerare nr. 1913, Objekti “Ferraj”, Qarku Tiranë”, me Subjekt Zhvillues “Ferraj” sh.p.k., ju bëjmë me dije se:

Shoqërisë “Ferraj” sh.p.k., i është dhënë e drejta nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet shkresës Nr. 574/1 prot (MIE), datë 10.05.2024, për fillimin e procedurës për zgjerimin e lejes minerare Nr.1913, datë 22.06.2021, për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror, objekti “Zall Herr”, Qarku Tiranë.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr. 10 304 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shprehemi dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër* sugjeron që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal në të. Sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Kamionat transportues të gurit gëlqeror të jenë të pajisura me bordura mbrojtëse dhe me mushama për të shmangur rënien aksidentale të gurit dhe përhapjen e pluhurave. Të pastrohen gomat e makinave kur të dalin nga territori.

- Të zbatohen standardet dhe praktikat më të mira gjatë përdorimit të lendeve plasese.

- Punëtorët të pajisen me kufje për mbrojtjen nga zhurma.

- Të përdoren sprucator për të shmangur përhapjen e grimcave të pluhurave si pasoje e shperthimeve gjatë shfrytëzimit të gurit gëlqeror

Shfrytëzimi i burimeve ujore të bëhet me Leje.

- Të bëhet trajtimi i ujerave të ndotur me grope dekantimi.

- Gjatë hapjeve të rrugëve të reja subjekti të ketë kujdes bimesinë në zonën ku do të ndërhyjë, duke pasur parasysh se në çdo rast të prerjeve apo shkuljeve të pemeve, gjatë fazës së rehabilitimit ato të zevendesohen me po të njëjtat lloj.

- Të parashikohen masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh.

- Të zbatohet orari sipas legjislacionit në fuqi për levizjen e automjeteve, për të shmangur vibrimet dhe zhurmat në zonat e banuara.

- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedis do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.

- Në rastet se gjatë venies në zbatim të projektit dhe funksionimit të tij do të verëhet prania e flores dhe e faunes të cilat janë specie të rrezikuara ose endemike të tregohet kujdes i veçantë për të mos dëmtuar ato.

- I gjithë territori i shfrytëzimit të rrethohet me rrjete për të parandaluar hyrjen e kafsheve të zonës

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* u krye datë 06.11.2024, ora 11:00, pranë objektit ku zhvillohej aktiviteti..

Në dëgjësë morën pjesë: Banorë të zonës përreth objektit, Kryeplaku, përfaqësues të pushtetit vendor, (Njësia Administrative Dajt), përfaqësues të studios IDE shpk, Eksperti i mjedisit dhe inxhinieri i minierës, Administratori dhe drejtuesi teknik i subjektit “Ferraj” shpk, të tjerë.

Nga pjesëmarrësit, banorë të fshatit, u shprehën pozitivisht për zhvillimin e veprimtarisë minerare

deri tani, duke theksuar se ky aktivitet jo vetëm që nuk i ka sjellë probleme në përgjithësi komunitetit, pot ai ka ndikuar pozitivisht, në drejtimin ekonomik, duke punësuar shumë banorë, si dhe duke ndihmuar me gur gëlqeror apo fraksioni të tij të gjithë banorët e zonës pa përjashtim. Pozitivisht u shpreh dhe kryeplaku i fshatit, të gjithë pjesmarrësit u shprehën dakort me vazhdimin e zhvillimit të veprimtarisë minerare për sipërfaqen që do të zgjerohet në Lejen minerre të shfrytëzimit nr. 1913, datë 22.06.2021, objekti Ferraj, Njësia Administrative Dajt, bashika Tironë, Qarku Tiranë.

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 166, datë 17.12.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.82, datë 02.05.2024, nr.4934 prot, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- Shkresë e MIE Nr. Nr. 574/1 prot , datë 10.05.2024, për fillimin e procedurës për zgjerimin e lejes minerare Nr.1913, datë 22.06.2021, për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror, objekti “Zall Herr”, Qarku Tiranë”.
- Shkresë nr.8369/1 prot, datë 20.09.2024 nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendim i Ministrisë së infrastrukturës dhe Energjisë
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

#### **4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**

**4.2** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

**4.3** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

**4.4** **Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.

**4.5** Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të veçantë.

#### **Gjatë fazës së instalimit:**

**4.6** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

**4.7** Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)

**4.8** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.

- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 **Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.21 **Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.22 Mbetjet që gjenerohen nga procesi i punimeve të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- 4.23 Të bëhet kontrolli i kushteve teknike në mënyrë periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve në gaz të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- 4.24 Të merren masa të sigurimit teknik që punimet të mos kryhen në oraret e papërshtatme dhe mbi normat e lejuara të zhurmave, si dhe të zbatohet Udhëzimi nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i ndryshuar.
- 4.25 Të përdoren automjete të mbuluara (të mbyllura ose të mbuluara me mbulesë të posaçme) për transportin e materialeve të thata.
- 4.26 Pastrimi i bimësisë të jetë i kufizuar vetem brenda kufijve ku do të zhvillohet projekti.
- 4.27 Pas përfundimit të fazës së punimeve, sugjerojmë rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të lira dhe krijimin e sipërfaqeve të gjelbërta, përreth objektit.
- 4.28 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.29 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.30 **Subjekti të marre masa për rehabilitim e sipërfaqes së shfrytëzuar.**

- 4.31** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.32** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.33 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

## 5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### - Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	19.06.2025	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	19.06.2025	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	19.06.2025	Çdo 6 muaj

Tabela e niveleve kufi:

### - Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	19.06.2025	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	19.06.2025	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

*Parametrat që duhet të monitorohen*

<b>Ndotësi</b>	<b>Përqëndrimi</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodiciteti</b>
Lëndët në pezulli	50 mg/l	19.06.2025	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
  - Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
  - Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
  - Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/çdo 6 muaj.
  - Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
  - Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**


*Konceptoi:*

*Konfirmoi:*

*Pranoi:*



**Aneksi 1. Harta me Koordinatat** (sipas lejes minerare ekzistuese Nr 1913, date 22.06.2021)



**Aneks 2: Harta me koordinatat** (sipas lejes minerare Nr 1913/1, te zgjeruar sipas urdherit të MIE Nr 574/1Prot, date 10.05.2024)

